



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:128158

Datë: 24.10.2024

Numri i dokumentit: 06347286

A.nr.1575/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtarin Rexhep Gashi dhe me zyrtaren ligjore Asliha Fejzullahu, si procesmbajtëse, në konfliktin administrativ të paditëses R. (H.) K. nga Prizreni, Rr. "M...", kundër të paditurës Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve-Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, të cilën sipas ligjit e përfaqëson Avokatura Shtetërore në Ministrinë e Drejtësisë, duke vendosur lidhur me padinë e paditëses për anulimin e vendimit me nr. të dosjes 6028255 i datës 14.03.2022, me kërkesë për pagesën e pensionit për personat me pa aftësi të përhershme, pas mbajtjes të seancës të shqyrtimit kryesor-publik, në prani të paditëses dhe në mungesë të përfaqësues ligjore të palës së paditur-Ministrisë së Drejtësisë-Avokaturës Shtetërore, me datë 16.10.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **APROVOHET NË TËRËSI E BAZUAR** kërkesëpadia e paditëses R. (H.) K. nga Prizreni, Rr. "M...".
- II. **ANULOHET** vendimi me nr. të dosjes 6028255 i datës 14.03.2022 i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve-Departamenti i Pensioneve në Prishtinë dhe paditëses R. (H.) K. nga Prizreni, i njihet e drejta në pension të pa aftësisë së përhershme për periudhë pesëvjeçare nga data 01.06.2021 e deri me datë 31.05.2026, përkatësisht deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore për njohjen e këtij pensioni.
- III. **DETYROHET** e paditura Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve-Departamenti i Pensioneve në Prishtinë që paditëses R. (H.) K. nga Prizreni, në emër të pensionit të pa aftësisë së përhershme, t'ia paguaj në mënyrë retoraktive shumën mujore prej 75€, në muaj nga data 01.06.2021 deri me datë 31.12.2021, kurse nga data 01.01.2022 e deri me datë 30.09.2024 t'ia paguaj shumën mujore prej 100€, në emër të pensionit të pa aftësisë së përhershme, e nga data 01.10.2024 t'ia paguaj shumën mujore prej 120 në emër të këtij pensioni, deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore për njohjen dhe pagesën e këtij pensioni.
- IV. Ky aktgjykim e zëvendëson vendimin me nr. të dosjes 6028255 i datës 14.03.2022 të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve-Departamenti i Pensioneve.
- V. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Me vendimin e kontestuar me nr. të dosjes 6028255 i datës 14.03.2022, e paditura Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve-Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, duke vepruar në ri procedurë sipas aktgjykimit të kësaj gjykate A.nr.1616/19 të datës 10.12.2021, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditëses për njohjen e të drejtës në pension të pa aftësisë së përhershme.

Paditësja e pa kënaqur me vendimin e kontestuar, me datë 22.06.2022, ka paraqitur padi në këtë gjykatë, me të cilën e ka iniciuar sërish konfliktin administrativ kundër të paditurës Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve në Prishtinë-Departamenti i Pensioneve, siç kuptohet nga padia për shkak se nuk janë aplikuar drejt dispozitat ligjore dhe për shkak se nuk është vërtetuar drejt gjendja faktike, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi i kontestuar i datës 14.03.2022 i të paditurës dhe gjykata vet ta miratoj kërkesën e paditëses për njohjen e të drejtës në pension me aftësi të kufizuar të përhershme, dhe kjo nga dita e paraqitjes së kërkesës, si dhe të urdhërohet e paditura që në afat prej 15 ditësh të nxjerr aktvendim bazuar në këtë aktgjykim.

Tutje në padi është deklaruar se organi i shkallës së dytë ka nxjerr vendim arbitrar pa u lëshuar fare në vërtetimin e gjendjes faktike dhe shqyrtimin e provave të bashkangjitura, pasi që ekzistojnë të gjitha provat, faktet dhe dëshmitë valide që të njihet e drejta në pension për persona me aftësi të kufizuar, pasi që e njëjta në bazë të diagnozës mjekësore nuk është e aftë ti përgjigjet nevojave personale. Ka paraqitur se mos ekzaminimi i palës nga ana e komisionit mjekësor, ka bërë që ndaj palës të krijohet parafytyrim i gabuar. Ka theksuar se organi i administratës së shkallës së dytë, i ka injoruar të gjitha provat dhe dëshmitë dhe nuk e ka kontrolluar fare personin në fjalë dhe në aktvendimin e lëshuar, nuk ka dhënë kurrfarë arsytimi pse ato nuk janë marr parasysh, por vetëm me arsytim të përgjithshëm se nuk ka dëshmi dhe e ka refuzuar ankesën.

Përgjatë seancave gjyqësore, në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare paditësja ka deklaruar mbetem pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke e njoftuar gjykatën se e ka pranuar ekspertizën mjekësore të mjekëve specialist të dt.23.09.2024 dhe pajtohet me mendimin e paraqitur në ekspertizë. Ka shtuar se pas dëgjimit të eksperteve mjekësor të pranishëm në seancë, konsiderojmë që është vërtetuar baza juridike e kërkesëpadisë, andaj i propozoj gjykatës që të nxjerr aktgjykim me të cilin aprovohet padia dhe kërkesëpadia e paditëses, anulohet vendimi i kontestuar të paditurës MFPT-DP i dt.14.03.2022 dhe paditëses ti njihet e drejta në pension të pa aftësisë së përhershme nga data 01.06.2021, për periudhë 5 vjeçare, si dhe të detyrohet e paditura që paditëses t'ia paguaj-kompensoj në mënyrë retroaktive në emër të pensionit të pa aftësisë së përhershme nga data 01.06.2021, shumën mujore prej 75€ në muaj deri me datë 31.12.2021, kurse nga data 01.01.2022 në emër të pensionit të lartcekur t'ia paguaj shumën mujore prej 100€ deri me datë 30.09.2024, kurse nga data 01.10.2024 e deri me datë 31.05.2026, t'ia paguaj shumen mujore prej 120€.

E paditura përmes përfaqësues ligjore Ministria e Drejtësisë-Avokatura Shtetërore në përgjigjen në padi të datës 30.11.2022 e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditëses. Ka theksuar se Departamenti i Ankesave duke vepruar sipas aktgjykimit A.nr.1616/2019 të datës 10.12.2021, me të cilin është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, është anuluar aktvendimi i MPMS-DP-së dhe çështja është kthyer në ri shqyrtim dhe ri vendosje tek e paditura, Komisioni Mjekësor me ekspert të lëmive përkatëse në seancën e datës 02.03.2022, pasi shqyrtoj shkresat e lëndës, dokumentacionin mjekësor dhe vlerësimin e komisionit mjekësor të shkallës së dytë, në përputhje me nenin 9 të ligjit të lartcekur është konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet për të qenë shfrytëzues i pensionit me aftësi të kufizuara.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 11.09.2024, ka shqyrtuar këtë konflikt administrativ komfor nenit 41 të LKA-së, në mungesë të përfaqësues ligjore të paditurës-Ministrisë së Drejtësisë-Avokaturës Shtetërore e cila kishte qenë e ftuar në mënyrë të rregullt për seancën gjyqësore të datës 27.08.2024, mirëpo askush nuk ka prezantuar dhe mos ardhjen në seancë nuk e ka arsytuar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 16.10.2024, sipas propozimit të palëve ndërgjyqëse ka administruar provat relevante dhe atë: Vendimin e MFPT-DP të dt.14.03.2022, Aktgjykimin e kësaj gjykate të dt. 10.12.2021, Raportet mjekësore për paditësen të datave; 17.06.2021, 15.06.2022, 16.06.2022, 01.11.2021, 24.02.2022, 26.11.2021, 23.11.2021, 05.01.2013, 17.11.2020, 05.04.2022, 04.05.2022, 16.11.2020, 01.06.2021, 27.05.2021, 25.05.2021, Kartonin Shëndetësor për paditësen me nr. K-196, Fletë daljen spitalore për paditësen me nr. të historisë 4349, Vendimin e MFPT-DP të dt.05.11.2021, Përmbledhjen e daljes nga spitali të paditëses të datës 14.03.2012, Ekspertizën mjekësore për paditësin të datës 23.09.2024, Formularin e Komisionit mjekësor të paditurës për paditësen.

Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 44 të LKA-së, ka shqyrtuar ligjshmërinë e vendimit kontestues, në drejtim të thënieve në padi, thënieve në përgjigje në padi, deklarimeve në seancë dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, konstatoi se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar, për këto arsye:

Nga provat shkresore të administruara në këtë procedurë gjyqësore të konfliktit administrativ, gjykata ka konstatuar që e paditura në shkallë të dytë përmes Këshillit të Ankesave, duke vepruar në ri procedurë sipas aktgjykimin të kësaj gjykate A.nr.1616/19 të datës 10.12.2021, me të cilin është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e këtij paditëses, është anuluar vendimi me nr.6028255 i datës 26.06.2019 i MPMS-së-DP-së, dhe çështja është kthyer në ri shqyrtim dhe ri vendosje, me vendimin e kontestuar me nr. të dosjes 6028255 i datës 14.03.2020 i ka refuzuar paditësen ankesën për njohjen e të drejtës në pension të pa aftësisë së përhershme. E paditura në vendimin e kontestuar ka theksuar se DP-ja duke vepruar sipas aktgjykimin të Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.1616/19 të datës 10.12.2021, në lidhje me padinë e znj. R. K., gjegjësisht komisioni mjekësor me ekspert të lëmive përkatëse në seancën e datës 02.03.2022, në mënyrë të gjithanshme përsëri i ka shqyrtuar shkresat e lëndës, pretendimet ankimore, dokumentacionin mjekësor që gjendet në lëndë dhe vlerësimin e Komisionit të shkallës së dytë, në përputhje me paragrafin 5 të nenit 9 të PAK, dhe ka konstatuar se nuk janë ofruar dëshmi të mjaftueshme për të qenë përfitues i pensionit për persona me pa aftësi të përhershme, prandaj Komisioni Mjekësor i caktuar enkas në ri procedurë pajtohet me vlerësimin e komisionit mjekësor të shkallës së dytë që nuk janë plotësuar kriteret e për PPAK dhe konform kësaj ankesën e refuzon si të pa bazuar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të saktë të gjendjes faktike në këtë konflikt administrativ, respektivisht mbi gjendjen shëndetësore të paditëses, gjykata në seancën gjyqësore të datës 23.11.2023, ka aprovuar propozimin e paditëses për nxjerrjen e provës me ekspertizë mjekësore, kurse me aktvendimin e datës 12.12.2023 të nxjerr jashtë seancë ka caktuar ekspertët mjekësor Dr. M. R. P.-Endokrinologe, Dr.Q. R.-Specialiste e Mjekësisë së Punës dhe Dr.V. B.-Internist, për ta kryer ekspertizën mjekësore në këtë konflikt administrativ, përkatësisht që bazuar në dokumentacionin i cili gjendet në shkresat e lëndës dhe ekzaminimin e drejtpërdrejt të paditëses të nxjerrin mendimin dhe konstatimin profesionale nëse tek paditësja ekziston pa aftësia e përhershme dhe e plotë për punë. Mjekët specialist të caktuar nga gjykata në ekspertizën mjekësore dorëzuar gjykatës, pas analizimit të dokumentacionit mjekësor i cili gjendet në shkresat e lëndës dhe ekzaminimin e drejtpërdrejt të paditëses kanë dhënë mendimin profesional se paditësja vuan nga disa diagnoza si janë; Diabet leit tip-2, Polineuripatia diabetike, Retinopatia diabetike, Hipertension arterial, Katarakte senile, St.post.Nephrectomia lat.des, andaj duke marr parasysh që këto sëmundje janë sëmundje kronike serioze dhe kërkojnë trajtim të përhershëm, të cilat i sjellin shumë vështirësi në kryerjen e aktiviteteve ditore, konkludohet se pacientja R. K. e lindur në vitin 1961 nga Prizreni ka aftësi të përhershme të kufizuar për punë.

Ekspertja mjekësore Dr.M. R. P.-Endokrinologe, në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se mbesim në tërësi pran ekspertizës mjekësore të dhënë me shkrim, duke cekur se deri te mendimi dhe konstatimi i paraqitur në ekspertizë kemi ardhur bazuar në dokumentacionin mjekësor të paditëses, nga ku ka rezultuar

që paditësja diku 17 vite është diagnostifikuar me diabet, e njëjta është me terapi me insulinë dhe me dy lloje te antidiabetikëve tabletare. Paditësja para 12 viteve e ka njëren veshkë të hequr. Sa i përket sheqerit mesatarja është mbi norme dhe gjithashtu edhe mesatarja për tre muaj. Po ashtu tek paditësja edhe vlerat e veshkës të cilën e ka janë mbi norme, një tjetër komplikim tek paditësja është edhe komplikimi në sy i njohur si retinopatia diabetike dhe katarakta senile, perdja në sy. Andaj bazuar në të gjitha diagnozat e konstatuara kemi ardhur në përfundim se tek paditësja ekziston pa aftësia për pune

Eksperti mjekësor Dr. V. B. në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar qëndroj në tërësi pran ekspertizës mjekësore, duke theksuar se në bazë të anamnezës së paditësës, kontrollit të dokumentacionit mjekësor dhe analizave tjera, konstatoj që pacientja vuan nga shtypja e lartë e gjakut, sëmundja e sheqerit insulinvarese, hiper tensioni arterial dhe nga komplikimet kronike të cilat i shkakton diabeti, polinneropati diabetike, nefropati diabetike, andaj në bazë të këtyre diagnozave të sipër përmendura konstatoj se pacientja ka pa aftësi të përhershme për pune.

Në pyetjen e gjykatës se në bazë të dokumentacionit mjekësor të cilën e keni pasur në shqyrtim, kjo pa aftësi e paditësës a ka ekzistuar nga data 01.06.2021, eksperti mjekësor Dr.V. B.-Internist u përgjigj se në bazë të dokumentacionit mjekësor, diagnozat aktuale të paditësës në 95% të tyre kanë ekzistuar edhe në vitin 2021, e që rrjedhimisht i bie që kjo pa aftësia ka qenë e njëjtë edhe në vitin 2021. Ai ka shtuar se tek mendimi i paraqitur në ekspertizë, konstatimi është që paditësja bazuar në gjendjen shëndetësore të cilën e ka, ka pa aftësi të plotë dhe të përhershme për punë.

Gjykata këtë ekspertizë mjekësore e mori në tërësi si të besueshme, për arsye se, e njëjta ishte profesionale, e argumentuar mirë sipas vëllimit të përcaktuar, për vërtetimin e fakteve vendimtare me rëndësi në këtë konflikt administrativ.

Në nenin 3 par.1 pika 1.6 të Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuar nga Shteti është paraparë “1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim: 1.6. Pensioni i pa aftësisë të përhershme - pensioni i rregullt mujor i paguar për qytetarët e Republikës së Kosovës, bazuar në vendimin e organit përkatës të Ministrisë, të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me këtë ligj”. Në vazhdim në nenin 9 të këtij ligji përcaktohet “1. Pensioni i pa aftësisë të përhershme do t’iu ofrojë mbështetje financiare personave të përzgjedhur në përputhje me kriteret e përcaktuara me këtë ligj, sipas mjeteve të ndara për këtë qëllim nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

2. Pensioni i pa aftësisë së përhershme do t’iu paguhet të gjithë atyre personave që janë shtetas të Republikës së Kosovës, që posedojnë dokumentet e identifikimit dhe të cilët i kanë tetëmbëdhjetë (18) deri gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç.

3. Kërkesa për pension të pa aftësisë së përhershme, duhet të parashtrohet në organet përkatëse të Ministrisë, të cilat janë të instaluar në Komunitet e Kosovës.

4. Kërkesat për pension të pa aftësisë së përhershme shqyrtohen dhe vlerësohen nga Komisionet Mjekësore, në Qendrat Rajonale të Administratës Pensionale.

5. Një person do të konsiderohet me pa aftësi të përhershme, nëse:

5.1. ofron dëshmi se është me pa aftësi të përhershme para se të aplikojë për pension, duke siguruar të gjitha dëshmitë mjekësore;

5.2. Komisioni Mjekësor vlerëson se ekziston pa aftësia e përhershme e punës të parashtruesi i kërkesës;

5.3. Komisioni Mjekësor vlerëson pa aftësinë në kohëzgjatje për periudhën prej një (1), tre (3) apo pesë (5) vitesh;

5.4. Pas skadimit të afateve të përcaktuara në nënparagrafin 5.3 të këtij paragrafi personi i nënshtrohet procedurës së rivlerësimit mjekësor.

6 Ministria apo Autoriteti përkatës mund t’i autorizojnë zyrtarët përgjegjës për inspektime të rastësishme apo sistematike të personave, të cilat marrin pensionin e pa aftësisë së përhershme, me qëllim të verifikimit

të fakteve të dhëna në kërkesë dhe vazhdimësisë së përzgjedhjes për shfrytëzimin e pensionit të aftësisë së kufizuar.

7. Procedurat e aplikimit dhe vlerësimit për pensionin e paaftësisë të përhershme duhet të përmbajnë rregulla të përcaktuara me qëllim të mbrojtjes së informatave mjekësore konfidenciale të aplikuesve të cilat do të përcaktohen me akte nënligjore”. Në nenin 5 par.1 të UA (MPMS) nr.06/2015 për Procedurat e Aplikimit dhe Vlerësimit për Pensionin e Paaftësisë së Përhershme përcaktohet se “E drejta për të aplikuar për pension të pa aftësisë së përhershme, ushtrohet përmes kërkesës së palës, përkatësisht formularit përkatësisht formularit për aplikim në pension i cili duhet të përmbajë: 1.1 emërtimin e organit të cilit i drejtohet; 1.2 emrin e kërkuesit; 1.3 arsyen për njohjen e të së drejtës në pension të pa aftësisë së përhershme; 1.4 datën e dorëzimit dhe 1.5 nënshkrimin”. Në paragrafin 2 të nenit 5 të këtij UA parashihet që “Kërkesës, duhet bashkëngjiten edhe këto dokumente si në vijim: 2.1 Dëshminë mjekësore se është me pa aftësi të përhershme; 2.2 Certifikatë apo raport mjekësor të lëshuar nga institucionet shëndetësore të nivelit sekondarë apo terciar. Në certifikatë duhet të jetë specifikuar vlerësimi i aftësisë së kufizuar, 2.3 Kopjen e dokumentit të identifikimit; 2.4 Ekstraktin nga Zyra Civile se është banor i përhershëm në adresën e caktuar; 2.5. Ekstraktin e lindjes; Një nga dëshmitë për faturat të cilat janë në emër të vet, faturën e tatimit në pronë, energjisë elektrike, ujit, mbeturinave, 2.7 Dëshmi tjera eventuale, të kërkuara nga zyrtari përgjegjës i zyrës pensionale përkatëse”. Në nenin 8 par.1, 2 dhe 3 të UA (MPMS) nr.06/2015 për Procedurat e Aplikimit dhe Vlerësimit për Pensionin e Paaftësisë së Përhershme thuhet se “1. Kërkesat për pension të paaftësisë së përhershme shqyrtohen dhe vlerësohen nga Komisioni Mjekësor i Departamentit të Pensioneve. 2. Komisioni Mjekësor, shqyrtimin e lëndës dhe ekzaminimet mjekësore i kryen në zyrat pensionale përkatëse. 3. Komisioni Mjekësor, në bazë të dëshmimeve mjekësore si dhe ekzaminimit të parashtruesit të kërkesës, vlerëson se e ekziston apo nuk ekziston paaftësia e përhershme tek parashtruesi i kërkesës”. Kurse në nenin 9 par.1 të UA të cekur më lartë përcaktohet se “Të gjithë shfrytëzuesit e pensionit të pa aftësisë së përhershme i nënshtrohen procedurës së ri vlerësimit mjekësor pas skadimit të afatit të përcaktuar prej 1 (një), tre (3) apo pesë (5) vitesh”.

Pas analizimit dhe vlerësimit të provave të cilat janë cekur më lartë, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar në ligj dhe fakte. Nga provat e administruara gjatë kësaj procedure të konfliktit administrativ siç janë; raportet mjekësore të paditësit të paraqitura si prova në procedurë administrative tek e paditura dhe në këtë procedurë gjyqësore të konfliktit administrativ, e në veçanti nga ekspertiza mjekësore e ekspertëve specialist mjekësor gjyqësor; Dr.M. R. P.-Endokrinologe, Dr.Q. R.-Specialiste e Mjekësisë së Punës dhe Dr.V. B.-Internist, të cilës gjykata ja fali besimin në tërësi, gjykata erdh në përfundim se paditësja i plotëson kushtet ligjore nga neni 9 par.5 të Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuar nga Shteti dhe neni 5 të UA (MPMS) nr.06/2015 për Procedurat e Aplikimit dhe Vlerësimit për Pensionin e Paaftësisë së Përhershme, për të qenë përfituese e pensionit të pa aftësisë së përhershme për periudhë pesëvjeçare nga data 01.06.2021, kur paditësja ka aplikuar tek e paditura për njohjen e të drejtës në pension të personave me pa aftësi të përhershme, e deri me datë 31.05.2026, përkatësisht deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore për njohjen e këtij pensioni, si në dispozitivin II të këtij aktgjykimi.

Gjykata thekson se e paditura edhe pse vendimin e kontestuar e ka nxjerr në ri procedurë duke vepruar sipas aktgjykimit të kësaj gjykate A.nr.1616/19 të datës 14.03.2022, me të cilin është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e këtij paditëses, është anuluar vendimi me nr.6028255 i datës 26.06.2019 i MPMS-së-DP-së, dhe çështja është kthyer në ri shqyrtim dhe ri vendosje, organi i paditur ka dështuar që ti përfillë vërejtjes e gjykatës lidhur me procedurën dhe pikëpamjet juridike të gjykatës, duke mos e pasur kësajsoj parasysh karakterin e detyrueshëm të aktgjykimit të paraparë me nenin 65 të LKA-së.

Gjykata konstaton se në vendimin e kontestuar, e paditura e ka përmendur faktin se komisioni mjekësor me ekspert të lëmive përkatëse në seancën e dt.02.03.2022, në mënyrë të gjithanshme përsëri i ka shqyrtuar shkresat e lëndës, pretendimet ankimore, dokumentacionin mjekësor që gjendet në lëndë dhe

vlerësimin e Komisionit të shkallës së dytë, në përputhje me paragrafin 5 të nenit 9 të PAK, dhe ka konstatuar se nuk janë ofruar dëshmi të mjaftueshme për të qenë përfitues i pensionit për persona me pa aftësi të përhershme. Gjykata thekson se nga ky konstatim nuk mund të kuptohet nëse e paditura-komisioni mjekësor i saj e ka bërë ekzaminimin e paditëses, për të ardhur deri tek konkluzioni i drejt i gjendjes faktike, ashtu siç parashihet me nenin 8 par.3 të UA (MPMS) nr.06/2015 për Procedurat e Aplikimit dhe Vlerësimin për Pensionin e Paaftësisë së Përhershme. Për më tepër e paditura në vendimin e organit të shkallës së parë të datës 05.11.2021, me të cilin e ka refuzuar kërkesën e paditëses të datës 01.06.2021 për njohjen e të drejtë në pension të pa aftësisë së përhershme, por edhe në vendimin e shkallës kontestuar në nxjerr në ri procedurë, me të cilin e ka refuzuar ankesën e paditëses, ka dështuar që të sqaroj se cilat prova i ka administruar në procedurë administrative, cilat fakte i ka provuar dhe argumentuar me atë prova, dhe si ka ardhur tek konkluzioni se paditësja nuk i ka plotësuar kriteret e parapara me Ligjin për Skemat Pensionale të Financuar nga Shteti.

Gjykata nga formulari i komisionit mjekësor të paditurës i cili i është bashkangjitur shkresave të lëndës me përgjigje në padi nga e paditura, konstaton se Komisioni Mjekësor i të paditurës në shkallë të parë me datë 12.04.2019, në shkallë të dytë me datë 05.06.2019, por edhe në ri procedurë me datë 02.03.2022, nuk ka dhënë vlerësimin se a ekziston ose jo pa aftësia e përhershme e paditëses, por në formular të vlerësimin e kanë shënuar fjalën refuzim dhe duke përzgjedhur opsionin refuzim, mirëpo një veprim i tillë i Komisionit Mjekësor, së bashku me formularin e vlerësimin, janë në kundërshtim me nenin 8 par.3 dhe 4 të UA (MPMS) nr.06/2015 për Procedurat e Aplikimit dhe Vlerësimin për Pensionin e Paaftësisë së Përhershme ku parashihet se *“3. Komisioni Mjekësor, në bazë dëshmive mjekësore si dhe ekzaminimit të parashtruesit të kërkesës, vlerëson se ekziston apo nuk ekziston pa aftësia e përhershme tek parashtruesi i kërkesës. 4. Komisioni Mjekësor, pas shqyrtimit dhe vlerësimin të kërkesës, lëndën së bashku me dokumentet përcjellëse, e kthen tek organi i shkallës së parë për marrjen e vendimit”*. Kështu që gjykata vlerëson se nuk ka qenë kompetencë e komisionit mjekësor të paditurës të vendos në lidhje me kërkesën e paditëses për njohjen ose refuzimin e kërkesës për pension të pa aftësisë së përhershme, por komisioni mjekësor ka pasur për detyrë vetëm ta vlerësoj se a ekziston apo nuk ekziston paaftësia e përhershme tek paditëses.

Në rrethanat e tilla faktike gjykata vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i të paditurës i dhënë në vendimin e kontestuar, se nuk janë ofruar dëshmi të mjaftueshme për të qenë shfrytëzues i pensionit me pa aftësi të përhershme, nuk është bazuar dhe i drejt, për shkak se, në rastin konkret nga ana e të paditurës nuk është vërtetuar drejt gjendja faktike dhe nuk janë aplikuar drejt dispozitat ligjore në fuqi, përkitazi me kushtet ligjore për njohjen e të drejtës në pension të paaftësisë së përhershme.

Gjykata konstaton se nga ekspertiza mjekësore e mjekëve specialist e datës 23.09.2024 e ekspertëve specialist mjekësor gjyqësor Dr.M. R. P.-Endokrinologe, Dr. Q. R.- Specialiste e Mjekësisë së Punës dhe Dr.V. B -Internist, është vërtetuar se paditësja vuan nga nga disa diagnoza si janë; Diabet leit tip-2, Polineuripatia diabetike, Retinopatia diabetike, Hipertension arterial, Katarakte senile, St.post.Nephrectomia lat.des, andaj duke marr parasysh që këto sëmundje janë sëmundje kronike serioze dhe kërkojnë trajtim të përhershëm, të cilat i sjellin shumë vështirësi në kryerjen e aktiviteteve ditore, andaj paditësja ka paaftësi të përhershme për punë, paaftësi kjo e cila ka qenë e njëjtë edhe në vitin 2021, pasi që diagnozat aktuale të paditëses në 95% të tyre kanë ekzistuar edhe në vitin 2021.

Nga një gjendje e tillë e çështjes gjykata vlerëson se pretendimet e paditëses janë plotësisht të bazuara dhe të drejta dhe se e njëjta i ka plotësuar kushtet ligjore për të qenë përfituese i pensionit të pa aftësisë të përhershme, sipas nenit 9 par.5 të Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuar nga Shteti dhe nenit 5 të UA (MPMS) nr.06/2015 për Procedurat e Aplikimit dhe Vlerësimin për Pensionin e Paaftësisë së Përhershme për periudhën nga data 01.06.2021, kur paditësja ka aplikuar tek e paditura për njohjen e

të drejtës në pension të personave me pa aftësi të përhershme, për periudhë 5 vjeçare e deri me datë 31.05.2026, përkatësisht deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore për njohjen e këtij pensioni.

Prandaj gjykata duke i pasur parasysh dispozitat ligjore nga neni 46 par.4 dhe 5 të LKA-së, dispozitën e nenit 20 par.1 të Ligjit nr.04/L-131 ku parashihet se “1. *Të gjitha pensionet që paguhen sipas këtij ligji, do të fillojnë të paguhen nga dita e parashtrimit të kërkesës*”, dhe precizimin e kërkesëpadisë të bërë nga paditësja, vendosi që krahas anulimit të vendimit të kontestuar të paditurës me nr. të dosjes 6028255 i datës 14.03.2022 në dispozitivin II të aktgjykimit dhe që paditëses ti njihet e drejta në pension të pa aftësisë së përhershme për periudhë pesëvjeçare nga data 01.06.2021 e deri me datë 31.05.2026, përkatësisht deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore për njohjen e këtij pensioni, në dispozitivin III të këtij aktgjykimi vendosi që të detyrohet e paditura që paditëses, në emër të pensionit të pa aftësisë së përhershme t’ia paguaj në mënyrë retroaktive shumën mujore prej prej 75€, në muaj nga data 01.06.2021 deri me datë 31.12.2021, kurse nga data 01.01.2022 e deri me datë 30.09.2024 t’ia paguaj shumën mujore prej 100€, në emër të pensionit të pa aftësisë së përhershme, e nga data 01.10.2024 t’ia paguaj shumen mujore prej 120 në emër të këtij pensioni,, respektivisht deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore për pagesën e këtij pensioni. Gjykata këtë vendimmarrje sa i përket lartësisë së pensionit të pa aftësisë së përhershme e bazoj në atë se lartësia e pensionit të pa aftësisë së përhershme deri me datë 31.12.2021 ka qenë në shumë mujore prej 75€, kurse nga data 01.01.2022 është rritur në shumën prej 100€ në muaj me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës me nr.05/54 të datës 12.01.2022, ndërsa me vendimin me nr.01/224 i datës 11.10.2024, pensioni i pa aftësisë së përhershme është rritur nga shuma 100€ në 120€ dhe kjo rritje është aplikuar nga muaji 10/2024.

Gjykata i ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës si dhe deklaratimet e palës së paditur të dhëna në përgjigjen në padi, përmes përfaqësues ligjore, mirëpo gjykata erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike administrative.

Vendimin që secila palë t’i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga sa u parashtrua më lartë, gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 46 par.2, 4 dhe 5 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr.1575/2022, datë 16.10.2024

G j y q t a r i
Rexhep Gashi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej **15 ditësh** nga marrja e të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.